



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____/2023

Datë: 27.07.2023

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 8 pika 1 dhe 1.2, nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, dhe nenin 21 dhe 22 të Rregullores (QRK)Nr. 09/2022 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 27.07.2023, pas diskutimit lidhur me pikën 6 të rendit të ditës: Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit Vlerësues për Miratimin e Vendimit Përfundimtar për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale me numër të Parcelave 00008-1 dhe 00008-2 së bashku me Objektet Përcjellëse me kohëzgjatje prej 20 vitesh, e miratoi këtë:

V E N D I M

Përfundimtar

për

Dhënien në Shfrytëzim të Pronës Komunale.

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës miraton vendimin përfundimtar për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale në parcelat me numër 00008-1 dhe 00008-2 së bashku me Objektet Përcjellëse me kohëzgjatje prej 20 viteve, ofertuesit Q.E.A GULISTAN O.P.
2. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme Komunale të cekur në pikën e 1 të këtij Vendimi është në kohëzgjatje prej 20 (njëzetë) viteve .
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të Pronës Komunale të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është funksionalizimi dhe përfitimi Ekonomik i Komunës nga Pronat Komunale.
4. Autorizohet Kryetari i Komunës së Gjakovës që brenda 10 ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të nënshkruaj kontratën me fituesin.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
6. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit

Arbënisha Kuqi
Kryesuesja e Kuvendit të Komunës



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	20.07.2023 01-011/A1-14545
Për:	Arbënështa Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Përmes:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Nga:	Brilanda Ballata, Kryesuese e Komisionit për shprehjen e interesit për Dhënien në Shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale me numër të parcelave 00008-1 dhe 00008-2, së bashku me objektet përcjellëse.
Lënda:	REKOMANDIM



Të nderuar,

Komisioni Vlerësues (i themeluar me vendim të Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numer 01 nr.011/01-4822 të datës 28.02.2023, në bazë të nenit 8 paragrafi 1 pika 1.2 nenit 19 paragrafi 3 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 21 dhe 22 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe Njoftimin Publik me numer 01. Nr. 353/01-11390 i dates 01.06.2023, me datën 20.07.2023, nxjerr këtë:

REKOMANDIM

1. Komisioni Vlerësues rekomandon Kuvendin e Komunës të miratojë vendimin përfundimtar për Dhënien në Shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale me numër të parcelave 00008-1 dhe 00008-2, së bashku me objektet përcjellëse, në kohzgjatje prej njëzet (20) vitesh, ofertuesin **Q.E.A GULISTAN O.P.**
2. Komisioni Vlerësues, pas vlersimit të ofertës së vetme, si dhe pas përfundimit të afatit të ankesave, oferta e përzgjedhur më e favorshme sipas kushteve të përcaktuara në Njoftimin Publik është: **Q.E.A GULISTAN O.P.**
3. Pas miratimit të vendimit përfundimtar, të autorizohet Kryetari i Komunës që brenda dhjetë (10) ditë pune nga hyrja në fuqi e vendimit përfundimtar të lidhë kontratën më fituesin.
4. Pjesë përbërëse e këtij Rekomandimi është: Raporti i Vlerësimit dhe Oferta e përzgjedhur.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Komision Vlerësues

Dt. 20.06.2023

Gjakovë

PROCESVERBAL

I përpiluar nga Komisioni Vlerësues me datën 20.06.2023, duke filluar në ora 10:00, në Objektin e Komunës së Gjakovës, Rruga "UÇK" (ish objekti i Bankosit), salla numër 8 Kabineti i Kryetarit të Komunës, i përbërë nga Brilanda Ballata, Flamur Fetahaj, Gani Hajdari, Mimoza Shala dhe Besim Kadriaj anëtarë, procesmbajtës Frrok Gjergjaj, për shprehjen e interesit për Dhënie në Shfrytëzim Aafatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale me numër të parcelave 00008-1 dhe 00008-2 se bashku me objektet përcjellëse, sipas vendimit paraprak të Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01nr.011/01-4819, datës 03.03.2023, njoftimit për shprehjen e interesit me numër 01-353/01-11390 të datës 01.06.2023.

Komisioni Vlerësues takimin e filloj në ora 10:00, dhe prezent janë:

Brilanda Ballata, kryesuese,

Flamur Fetahaj, anëtar

dhe Gani Hajdari, anëtar.

Ndërsa munguan:

Mimoza Shala, anëtare

dhe besim Kadria, anetar.

Kryesuesja e komisionit fillimisht njoftoj të pranishmit për procedurat e hapjes së ofertave dhe të drejtat e tyre sipas legjislacionit në fuqi.

Kryesuesi i komisionit pasi vërteton se nuk ka konflikt interesi nga ai dhe anëtarët e komisionit, në prani të ofertuesve, bënë hapjen e ofertave.

Në këtë procedurë ka marrë pjesë një (1) ofertues: Q.E.A GULISTAN O.P. i përfaqësuar nga Sen Turgay,

Kryesuesja e Komisioni: Në prezencë të anëtareve dhe të ofertuesit thekson se ofertuesi ka aplikuar me tri pliko - zarfa të mbyllura, së bashku me anëtarët e komisionit është hapur zarfi me dokumente origjinale duke i verifikuar të gjitha dokumenteve e nevojshme për aplikim si vijon:

Aplikacioni

Kopja e Letërnjoftimit të përfaqësuesit të biznesit / personit fizik;

Certifikatën e regjistrimit të biznesit;


Plani i biznesit i cili duhet të përmbaj planin dinamik të investimeve;
Vërtetimin e shlyerjes së obligimeve ndaj ATK-së, për biznesin ekzistues - origjinali;
Dëshmia nga ATK-ja për numrin aktual të të punësuarave (për biznesin ekzistues);
Dëshmia nga aplikuesi që nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të
lëshuar nga Gjykata kompetente – dokumenti origjinal;
Dëshmia nga ATK-ja për qarkullimin e biznesit për 2 vitet e fundit (për biznesin e ekzistues)
Vërtetimin e shlyerjes së obligimeve të tatimit në pronë;
Licencat për ushtrimin e aktivitetit edukativ arsimor të lëshuar nga MASHT-ti

Kryesuesja dhe anëtarët e komisionit konstatuan se të gjitha dokumentet nevojshme për aplikim dhe kriteret për përzgjedhjen e ofertave janë prezantuar nga ofertuesi në përputhshmëri me njoftimit publik.

Kryesuesja e konstaton se në bazë të të gjithë dokumenteve të prezantuara nga ofertuesi i vetëm i ne këtë aplikim Q.E.A GULISTAN O.P. i përfaqësuar nga Sen Turgay, i njëjti shpallet fitues.


Takimi i Komisionit përfundoj në ora 11:25


Procesmbajtës



Errok Gjergj




Anëtarët e Komisionit


Brilanda Ballata


Flamur Fetahaj


Gani Hajdari

Ofertuesi


Sen Turgay,



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Komision Vlerësues
Dt. 20.06.2023
Gjakovë

Komisioni Vlerësues (i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01nr.011/01-4819, datës 03.03.2023, me datën 20.06.2023, në mbledhjen e mbajtur me datë 20.06.2023, nxjerr këtë:

R A P O R T

Pas mbylljes së njoftimit publik, Komisioni Vlerësues, brenda afatit ligjor ka filluar procedurën për hapjen e ofertës pasi që Kryesuesi i Komisionit vërteton se nuk ka konflikt interesi nga ai dhe anëtarët e Komisionit.

Në bazë të Njoftimit Publik 01Nr.353/01-11390 të datës 01.06.2023 për Shprehjen e Interesit për Dhënie në Shfrytëzim Aafatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale me numër të parcelave 00008-1 dhe 00008-2 së bashku me objektet përcjellëse, ka aplikuar vetëm një ofertues **Q.E.A GULISTAN O.P.**

Komisioni në prani të ofertuesit të vetëm, ka bërë hapjen e ofertave ku identifikuan dhe i shqyrtuan të gjitha dokumentet e nevojshme *për aplikim si vijon:*

Aplikacioni;

Kopja e Letërnyjftimit të përfaqësuesit të biznesit / personit fizik;

Certifikatën e regjistrimit të biznesit;

Plani i biznesit i cili duhet të përmbaj planin dinamik të investimeve;

Vërtetimin e shlyerjes së obligimeve ndaj ATK-së, për biznesin ekzistues - origjinali;

Dëshmia nga ATK-ja për numrin aktual të të punësuarave (për biznesin ekzistues);

Dëshmia nga aplikuesi që nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata kompetente – dokumenti origjinal;

Dëshmia nga ATK-ja për qarkullimin e biznesit për 2 vitet e fundit (për biznesin e ekzistues)

Vërtetimin e shlyerjes së obligimeve të tatimit në pronë;

Licencat për ushtrimin e aktivitetit edukativ arsimor të lëshuar nga MASHT-ti

Komisioni Vlerësues pas verifikimit të të gjitha dokumentet të prezantuar nga ofertuesi konstaton se janë në përputhje me kriteret e Njoftimit Publik, po ashtu të gjitha dokumentet janë prezantuar në origjinalitet.

Në bazë të njoftimit Publik 01Nr.353/01-11390 të datës 01.06.2023 për shprehjen e interesit Komisioni Vlerësues ka shqyrtuar edhe kriteret për përzgjedhjen e ofertave. Vlerësimi i kriterëve është bërë në bazë të poentimit sipas pikëve për secilin kriter të lartcekur. Dhe në bazë të vlerësimit, ofertuesi nga Komisioni Vlerësues është vlerësuar me 95 pikë.

Kriteret për zgjedhjen e ofertave sipas Njoftimit Publik kanë qenë si vijon:

Oferta ekonomikisht më e favorshme që përfshinë:

Çmimi fillestar 1000 euro (0 - 40 pikë)

Vlera e investimit dhe veprimtaria biznesorë sipas destinimit të pronës në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) vitesh (0- 20 pikë)

Numri i të punësuarve nga investimi (0 – 15 pikë);

Lista e të punësuarave aktual dhe kualifikimi i tyre (0 - 15 pikë)

Lloji i investimit që është me interes publik me prioritet për komunën (0 - 10 pikë).

Komisioni Vlerësues duke vepruar në harmonitë plotë me Ligjin Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale si dhe Njoftimit Publik 01Nr.353/01-11390 të datës 01.06.2023 për Shprehjen e Interesit për Dhënien në Shfrytëzim Aafatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale me numër të parcelave 00008-1 dhe 00008-2 se bashku me objektet përcjellëse.

Komisioni në bazë të pikëve të grumbulluara konform Njoftimit Publik, unanimisht vendosi që ofertuesi i vetëm të përzgjedhet **Q.E.A GULISTAN O.P.**


Kryesuesja e Komisionit
Brilanda Ballata



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01Nr. 353/01-11390
Dt: 01.06.2023

Komisioni Vlerësues (i themeluar me vendimin e Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numër 01nr.011/01-4819, datës 03.03.2023, duke u bazuar në nenet 4, 5 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.2 dhe neni 15 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 14, 15, 17, 19 dhe të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës me qëllim të zbatimit të vendimit paraprak me numër 01 011-4819 të datës 03.03.2023 të miratuar nga Kuvendi Komunal për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale, me datë 01.06.2023 shpallë këtë:

NJOFTIM PUBLIK

Për shprehjen e interesit për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale me numër të parcelave 00008-1 dhe 00008-2 së bashku me objektet përcjellëse.

Ftohen të gjithë të interesuarit të paraqesin ofertat e tyre për marrjen në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale, sipas njoftimit publik të shpallur nga komuna të parcelave 00008-1 dhe 00008-2 së bashku me objektet përcjellëse, në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) vitesh.

QËLLIMI

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale është:

- Përfitimi ekonomik i komunës përmes qiradhënies;
- Funksionalizimi i pronës komunale.

Destinimi i pronës:

Prona e Paluajtshme Komunale me numër të parcelave 00008-1 dhe 00008-2 së bashku me objektet përcjellëse, do jetë me destinim shfrytëzimi për ushtrimin e aktiviteteve edukative arsimore.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Aplikacioni;
- Kopja e Letërnjoftimit të përfaqësuesit të biznesit/personit fizik;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Plani i biznesit i cili duhet të përmbaj planin dinamik të investimeve;
- Vërtetimin e shlyerjes së obligimeve ndaj ATK-së, për biznesin ekzistues – (origjinali);
- Dëshmia nga ATK-ja për numrin aktual të të punësuarave (për biznesin ekzistues);
- Dëshmia nga aplikuesi që nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata kompetente – (dokumenti origjinal);
- Dëshmia nga ATK-ja për qarkullimin e biznesit për 2 vitet e fundit (për biznesin e ekzistues);
- Vërtetimin e shlyerjes së obligimeve të tatimit në pronë;
- Licencat për ushtrimin e aktivitetit edukativ arsimor të lëshuar nga MASHT-ti.

Kriteret për zgjedhjen e ofertave:

Oferta ekonomikisht më e favorshme që përfshinë:

- Çmimi fillestar 1000 euro në muaj (0 - 40 pikë);
- Vlera e investimit dhe veprimtaria biznesorë sipas destinimit të pronës në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) vitesh (0- 20 pikë);
- Numri i të punësuarave nga investimi (0 – 15 pikë);
- Lista e të punësuarave aktual dhe kualifikimi i tyre (0 - 15 pikë);
- Lloji i investimit që është me interes publik me prioritet për komunën (0 - 10 pikë).

Vlerësimi i kriterëve bëhet me poctim sipas pikëve për secilin kriter të lartcekur. Ofertuesi që mbledh më së shumti pikë shpallet fitues (pikët maksimale janë 100).

Pjesëmarrësit në konkurrim i garantohet e drejta që:

- Të informohen me procedurat e shprehjes së interesit;
- Të shohin pronën që jepet në shfrytëzim;
- Të kenë qasje në dokumentacionet e pronës;
- Të tërhiqen nga konkursi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave.

Kushtet e përgjithshme të njoftimit publik për shprehjen e interesit:

- Afati për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale do të jetë afatgjatë deri në njëzetë (20) vite.

- Kohëzgjatja e shpalljes së njoftimit publik për shprehjen e interesit për dhënien e pronës në shfrytëzim afatgjatë është pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e publikimit në ueb – faqe të Komunës dhe në vendet publike. Ofertat me dokumentacionin e plotësuar, duhet të dorëzohen të mbyllura (në pliko) në Komunën e Gjakovës, në Zyrën e Pranimi, kati përdhes, adresa: rruga “UÇK”, Nr. 53, 50000 Gjakovë.
- Aplikimi fillon nga data **01.06.2023** deri me datë **15.06.2023** në orën **15:30h** dhe të protokollohet nga Komuna.
- **Vendi dhe koha ku do të mbahet njoftimit publik për shprehjen e interesit:** Objekti i Komunës së Gjakovës, Rruga “UÇK” (ish objekti i Bankosit), kati IV, salla e asamblesë komunale, me datë **20.06.2023** nga ora **10:00h**. Fillimisht bëhet hapja e ofertave të mbyllura në formë publike, duke siguruar qasje të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit në ankand publik.
- Procedurat e njoftimit publik për shprehjen e interesit mund të zhvillohen edhe në rastin kur paraqitet vetëm një ofertues me kusht që të jenë plotësuar të gjitha kriteret tjera të përcaktuara.
- **Vlerësimi i ofertave dhe procedura e nënshkrimit të kontratës:** Komisioni Vlerësues brenda tre (3) ditësh pune pas mbylljes së njoftimit publik, fton pjesëmarrësit për hapjen e ankandit dhe vlerësimin e ofertave.
- Kryesuesi/ja i/e komisionit pasi vërteton se nuk ka konflikt interesi nga ai/ajo dhe anëtarët e komisionit, në prani të ofertuesve, bën hapjen e ofertave ku identifikohen të gjitha çmimet e ofertuesve. Pas vlerësimit të ofertave të njoftimit publik për shprehjen e interesit ankand publik, Komisioni Vlerësues harton raportin përfundimtar dhe për zgjedh ofertën fituese dhe rekomandon Kryetarin për dërgim/miratim në Kuvend. Nëse kuvendi miraton vendimin përfundimtar, atëherë autorizon Kryetarin e Komunës që brenda dhjetë (10) ditësh pune nga hyrja në fuqi e vendimit të lidhë kontratën me fituesin.

Vërejtje: Ofertuesit që nuk i bashkëngjisin të gjitha dokumentet e nevojshme, diskualifikohen dhe oferta e tyre nuk do të shqyrtohet fare.

Kryesuesja e Komisionit

Brilanda Ballata



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 463/02-12857
Dt: 21.06.2023

Komisioni Vlerësues (i themeluar me vendim të Kuvendit të Komunës së Gjakovës, me numer 01 nr.011/01-4822 të datës 28.02.2023 ne bazë të nenit 8 pika 1.2 nenit 19 pika 1 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 21 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës me qëllim të zbatimit të vendimit paraprak me numer 01 nr.011/01-4822 të datës 28.02.2023 të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës për dhenien e pronës në shfrytëzim afatëgjatë të pronës komunale si dhe Njoftimin Publik me numer 01, Nr. 353/01-11390 i dates 01.06.2023, në mbledhjen e mbajtur me datë 20.06.2023, komisioni shpall këtë:

NJOFTIM

Për shprehjen e interesit për Dhënien në Shfrytëzim afatëgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale me numër të parcelave 00008-1 dhe 00008-2, së bashku me objektet përcjellëse.

Komisioni, pas pranimit të ofertave ka bërë vlerësimin e tyre në përputhje me kushtet e përcaktuara në njoftimin publik dhe ka përzgjedhur: **Q.E.A GULISTAN O.P.**


Njoftimi për ofertën e përzgjedhur, i dërgohet fituesit dhe vendoset në tabelën e shpalljeve publike dhe në web-faqen zyrtare të Komunës.

Këshill Juridike: Pala e pakënaqur me vlerësimin e komisionit ka të drejtë të parashtrojë ankesë në "Komisionin për ankesa" në afat prej shtatë (7) ditësh pas shpalljes në web-faqen zyrtarë të Komunës.



Brilanda Ballata

Kryesuese e Komisionit



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës Arbëresha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Fehmi Zena, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Besim Myrtezani, zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL-së	Date: 20/03/ 2022
Zyrtarët përgjegjës:	Gëzim Sahiti, Zv. Udhëheqës i Divizionit të Monitorimit	Nr. 020-220
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Driton Xhafa, Zyrtar për Monitorimin e Komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë e aktit të komunës së Gjakovës	
Lloji i aktit:	Vendimi Nr. 011-01-4822	

I/e nderuar Kryetar,

I/e nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshimplotësimin e Rregullos (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim paraprak Nr. 011-01-4822 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluaftshme të komunës
I miratuar më datë: 28.02.2023
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 03.03.2023

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ndërsa sa i përket përmbajtjes së aktit si dhe obligimeve ndaj palëve tjera janë në përgjegjësi të komunës. Komuna duhet të sigurohet që të ketë të themeluar dhe funksional komisionin e ankesave.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Gjakovës në mbledhjen e mbajtur në datë 28.02.2023, ka miratuar Vendim paraprak Nr. 011-01-4822 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës.

MAPL, konstaton se vendimi i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës është i bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale nën 12, Ligjin Nr.06/L-92 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës nën 6, 7 dhe 8 si dhe Rregulloren (QRK) Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës nën 5 dhe 6.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Gjakovës me datë 28.02.2023 me 28 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim. Vendim paraprak Nr. 011-01-4822 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës bëhet me qëllim që nga parcelat nr. 00008-1 dhe 00008-2 dhe objektet përcjellëse të saj komuna e Gjakovës të sigurojë përfitime ekonomike.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshme lidhur me këtë vlerësim.




Kuvendi i Komunës së Gjakovës
01 Nr. /2023
Datë: 28.02.2023

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe në nenin 15 të Statutit të Komunës së Gjakovës 01 nr. 011/04-29365 i datës 30.12.2022, Nenin 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së paluajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2023 pas diskutimit lidhur me pikën e 9 të rendit të ditës: Propozim-vendimi për formimin e Komisionit Vlerësues për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale me numër të parcelës 00008-1 dhe 00008-2 si dhe objektet përcjellëse, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni Vlerësues për Dhënie në Shfrytëzim Afatgjatë në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) viteve të Pronës së paluajtshme Komunale me numër të parcelës 00008-1 dhe 00008-2, me këtë përbërje:
 1. z. Flamur Fetahaj, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës.
 2. z. Gani Hajdari, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës.
 3. z. Besim Kadrija, përfaqësues i Kuvendit të Komunës.
 4. znj. Mimoza Shala, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës.
 5. znj. Brilanda Ballata, përfaqësuese e sektorit jo qeveritar.
2. Komisioni Vlerësues për Dhënie në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës Komunale ka për detyrë dhe përgjegjësi që të zhvillojë procedurat e parapara me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale për pronën e cekura në pikën 1 të këtij vendimi për të cilin është nxjerrë vendimi paraprak nga Kuvendi i Komunës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e Komunës.
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
 - Anëtarëve të Komisioni Vlerësues.
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit

Arbëneshë Rugi
Kryesuesja e Kuvendit të Komunës



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. /2023

Datë: 28.02.2023

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 5 nenit 6 pika 1.2, nenit 7.8 pika 1.2 dhe nenit 14 të Ligjit nr.06/L-092 për Dhënie në shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2023, pas diskutimit lidhur me pikën 8 të rendit të ditës Propozim-vendimi për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të Pronës së paluajtshme Komunale me numër të parcelës 00008-1 dhe 00008-2 si dhe objektet përcjellëse, e miratoi këtë:

V E N D I M

Paraparak

për

Dhënie në shfrytëzim të pronës Komunale

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës miraton vendimin paraparak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale me numër të parcelave 00008-1 dhe 00008-2 si dhe objektet përcjellëse që janë në pronësi të Komunës së Gjakovës .
2. Afati kohor për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme Komunale të cekur në pikën e parë të këtij Vendimi është në kohëzgjatje prej 20 (njëzetë) viteve .
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të Pronës Komunale të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është funksionalizimi dhe përfitim Ekonomik i Komunës nga Pronat Komunale .
4. Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë realizohet përmes njoftimit publik në harmoni me nenin 15 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .
6. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini
 - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
 - Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë
 - Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës
 - Arkivit



Arbëneshaj, Baki

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës



KOMISIONI PËR VLERËSIMIN E OFERTAVE

FORMULARI I APLIKIMIT

PËR PERSONAT FIZIK

PËR PERSONAT JURIDIK:

Emri dhe Mbiemri FATIL BAKA

Titulli (Firma / Emri) i personit juridik TONGAY GENÇLÜSTAN

Adresa e banimit $\mathbb{R}^2 \times \mathbb{R}^2$ Dohy - Gjakovë

Emri dhe mbiemri i përfqësuesit: TULLOCH & CH

Numri personal i L.nj. 1931294593

Selia e personit juridik

Kontakti 063752430

Numri i Biznesit 70462416

Nr. i parcellës	Adresa
00008-1	Z. Pajëti Bogdani
00008-2	Z. Pajëti Bogdani



Data: 13.06.2023

Nr. Prot.: 23/061301

PLANI DINAMIK I INVESTIMEVE

Q.E.A Gulistan, me shkollën "Mehmet Akif" në Gjakovë, pas shpalljes së njoftimit publik me datën 01.06.2023 (Për shprehjen e interesit për Dhënien në Shfrytëzim Afatgjatë të Pronës së Paluajtshme Komunale me numër të parcelave 00008-1 dhe 00008-2 së bashku me objektet përcjellëse), ka bërë planin dinamik të investimeve si mëposhtë:

- Oferta për çmimin mujor të jetë 1100 Euro.
- Vlera e investimit në kohëzgjatje prej 20 (njëzet) viteve të jetë 2.1 milionë euro. Fazat e investimit do të jenë si mëposhtë:
 - 2023-2025: 600.000 Euro (Faza e parë e ndërtimit të objektit)
 - 2027-2030: 700.000 Euro (Faza e dytë e ndërtimit të objektit)
 - 2031-2034: 400.000 Euro (Ndërtimi i sallës së sportit)
 - 2023-2043: 400.000 Euro (Investimi në materiale arsimore)

Hapësirat e kampusit

Brenda kampusit do të ndërtohen objekte moderne, salla e sportit, menza për ushqim, kabinete të teknologjisë, klasa me teknologjinë e fundit për zhvillimin e procesit mësimor, kabineti i robotikës dhe i kodimit, kabineti për klubin e filmit, salla e konferencave me mundësi për mbledhje online dhe laboratore të ndryshme.

Numri i të punësuarve nga investimi do të jetë 60.

Lista e të punësuarve aktual dhe kualifikimi i tyre:

- | | |
|--|---|
| 1. Adelina Gashi- Mësuese Klasore | 15. Dafina Rudi- Staf i Kuzhinës |
| 2. Adelina Shala- Mësimdhënëse e Gjeografisë | 16. Diana Cana- Staf i Kuzhinës |
| 3. Aida Meqa Këpuska- Mësuese Klasore | 17. Diellza Nallbani- Mësimdhënëse e Informatikës |
| 4. Albin Muhaxhiri- Mësimdhënësi i Informatikës | 18. Dorina Doli- Mësuese Klasore |
| 5. Alma Stuja- Mësimdhënëse e Gjuhës Shqipe | 19. Edona Huma Jaka- Edukatore |
| 6. Amela Bokshi- Mësimdhënëse e Matematikës | 20. Elona Domi- Mësimdhënëse e Gjuhës Gjermane |
| 7. Anella Shala- Zëvendës drejtoreshë e ciklit të ulët | 21. Erenik Dujaka- Mësimdhënësi i Gjuhës Angleze |
| 8. Arafat Qafleshi- Mësimdhënësi i Gjuhës Gjermane | 22. Erisa Koshi- Mësimdhënëse e Edukatës Muzikore |
| 9. Arjeta Kursani Thaqi- Mësuese Klasore | 23. Fatih Bamja- Drejtor i Shkollës |
| 10. Armend Dodaj- Mësimdhënësi i Fizikës | 24. Fjolla Asllani- Mësimdhënëse e Gjuhës Angleze |
| 11. Arrita Kursani- Mësimdhënëse e Edukatës Fizike | 25. Flamur Ajdini- Staf Teknik |
| 12. Besjana Vula- Edukatore | 26. Florentina Selmanaj- Asistente |
| 13. Bestar Vula- Mësimdhënësi i Historisë | 27. Getuarba Haklaj- Mësimdhënëse e Edukatës Fizike |
| 14. Blenda Buza- Mësuese Klasore | |

28. Ilirjana Lima Domi- Staf i Kuzhinës
29. Kaltrina Xharra- Mësimdhënëse e Kimisë
30. Klementina Duraku- Mësimdhënëse e Biologjisë
31. Krenare Roka Lleshi- Administratore
32. Ljorika Zhubi- Mësimdhënëse e Gjuhës Angleze
33. Mërgim Balija- Mësimdhënësi i Fizikës
34. Mimoza Daija- Zëvendës drejtoreshë e ciklit të mesëm të ulët
35. Mirjeta Morina- Staf i Pastrimit
36. Mrika Rexhaj- Mësimdhënëse e Gjuhës Angleze
37. Natyra Haxhiavdyli- Mësimdhënëse e Gjuhës Angleze
38. Nexhmedin Hoti- Staf i Kuzhinës

39. Omer Güven- Mësimdhënësi i Gjuhës Turke
40. Prene Morina- Staf i Kuzhinës
41. Sanije Hoti- Mësimdhënëse e Gjuhës Shqipe
42. Senad Arifi- Zëvendës drejtor i ciklit të mesëm të lartë
43. Shega Ramadani- Mësimdhënëse e Matematikës
44. Shehzane Zeka- Staf i Pastrimit
45. Shpat Hoxha- Mësimdhënësi i Edukatës Fizike
46. Sibora Gojani- Administratore
47. Taulant Hajdari- Mësimdhënësi i Artit Figurativ
48. Vjosa Byci Dulatahu- Mësuese Klasore
49. Ylber Sahitaj- Psikolog
50. Yllka Bakalli Vula- Mësuese Klasore

Investimi do të jetë me interes publik pasi që shkollat "Mehmet Akif" në Kosovë kanë treguar sukses të jashtëzakonshëm në fushën e arsimit dhe edukimit. Më poshtë janë të dhënat për shkollat "Mehmet Akif":

Që nga viti 2000, Qendra edukativo-arsimore Gülistan ushtron veprimtarinë e saj në fushën e arsimit dhe të edukimit. Vitin shkollor 2022-2023 kemi filluar, përafërsisht, me 2000 nxënës dhe 250 të punësuar.

Historiku i shkollavë "Mehmet Akif"

"Shkolla Mehmet Akif" është shkolla e parë private e hapur në Kosovën e pasluftës. Veprimtarinë e ka filluar në vitin 2000, në lokalet e Shkolles së mesme "Gjin Gazuli", në Prishtinë. Një vit më vonë është transferuar si qiramarrës fillimisht në një objekt që gjendej në Velani, kurse më vonë në objektin që gjendej në Veternik.

Në vitin shkollor 2010 Kolegji kaloi në objektin e vet aktuale në Banullë-Lipjan.

Mësimi zhvillohet në nivelin fillor, në nivelin e mesëm të ulët dhe në nivelin e mesëm të lartë në drejtimin shkencor.

Shkolla ofron ushqim si dhe banim në konvikte të ndara për djem dhe vajza, për nxënësit që vijnë nga qytetet e tjera të Kosovës.

"Shkolla Mehmet Akif" në Prizren është hapur në vitin 2006, te ish-Fabrika e Përllonkes. Ndërsa, në vitin 2011 kaloi në objektin e vet që gjendet në Boka-Korishë.

Mësimi zhvillohet në nivelin fillor, në nivelin e mesëm të ulët dhe në nivelin e mesëm të lartë në drejtimin shkencor.

Shkolla Mehmet Akif" në Gjakovë u hap në vitin 2010 në objektet e ish-TMK-së, vendi i ashtuquajtur "Zidi Sadik Agës" i cili është pronë e Kuvendit Komunal të Gjakovës dhe është marrë në shfrytëzim për një kohë të caktuar nga Komuna e Gjakovës.

Fillimisht është bërë riparimi i objektit në fjalë në mënyrë që të jetë sa më i përshtatshëm për procesin mësimor. Me fillimin e vitit shkollor është bërë pranimi i nxënësve për kl.I-rë, VI-të dhe IX-të. Si rezultat i interesimit të qytetarëve është hapur edhe niveli parashkollor fillimisht me dy grupe. Në fund të vitit shkollor 2013-2014 niveli I –rë ka kaluar në objektin e ri i cili po ashtu gjendet në oborrin e kësaj shkolle. Mësimi zhvillohet në nivelin parashkollor, në nivelin fillor, në nivelin e mesëm të ulët dhe në nivelin e mesëm të lartë në drejtimin shkencor.

Qëllimet e shkollave "Mehmet Akif"

Nxënësit tanë;

- Të zhvillohen në mënyrë të shëndoshë dhe të balansuar në pikëpamje shpirtërore, morale, mendore dhe fizike
- Të jenë të vetëdijshëm për ngjarjet dhe problemet aktuale në botë, të jenë të përgjegjshëm ndaj shoqërisë, të mendojnë në mënyrë të lirë dhe të kenë mendim shkencor
- T'i zhvillojnë aftësitë dhe talentet e tyre me metoda bashkëkohore
- Të jenë në mesin e të parëve sa i përket suksesit në provimet pranues të institucioneve arsimore të mesme dhe të larta
- T'i zhvillojnë aftësitë e tyre në artet e bukura siç janë: vizatim, muzikë, teatër etj.
- Të kenë sukses në çdo disiplinë të sportit në nivel vendi dhe nivel ndërkombëtar
- Të jenë në nivel bashkëkohor sa i përket komunikimit efektiv me të gjithë njerëzit në këtë botë të globalizuar, pa dallim të gjuhës, përkatësisë fetare dhe përkatësisë etnike
- T'i përcjellin në vazhdimësi risitë dhe të jenë në gjendje që t'i shfrytëzojnë teknologjitë informative në mënyrë aktive
- Të edukohen në atë masë sa që t'i marrin vendet e para në gara të projekteve dhe në olimpiada shkencore në nivel vendi dhe nivel ndërkombëtar.

Për mësimdhënësit tanë;

- Të ofrojmë mundësi teknike, sociale dhe psikologjike për t'i ngritur në nivelin më të lartë aftësitë e tyre
- Të ofrojmë kushte optimale ekonomike që të jenë të kënaqur për t'i përcjellur zhvillimet e fundit në fushën e tyre për aftësim profesional.
- Të kenë raporte të mira me nxënës dhe me prindër
- Të informohen vazhdimisht për zhvillimet e fundit në fushën e edukimit dhe rezultatet e arsimit në mënyrë që të absorbojnë njohuri të ndryshme

Për punonjësit tjerë sigurojmë që;

- Të jenë persona që punojnë me dëshirë dhe pasion si dhe të kenë bashkëpunim të mirë me administratën
- Të jenë shembull për nxënës me sjelljet e tyre të mira
- Të shpërblehen në çdo sukses të treguar për zhvillimin e tyre profesional
- Të bëjnë punë ekipore të cilat i kryejnë me saktësi dhe me kohë përgjegjësitë dhe detyrat e tyre si dhe të kenë një sjellje dhe filozofi të cilësisë së lartë

Drejtor i përgjithshëm
Turgay Şen





VËRTETIM TATIMOR TAX VERIFICATION PORESKA POTVRDA

Administrata Tatimore e Kosovës verifikon se personi i identifikuar më poshtë:
Tax Administration of Kosovo certifies that the person identified below:
Poreska Administracija Kosova overava da dolje identifikaciono lice:



1001070726

Emri i personit:
Name of Person:
Ime lice:

Q.E.A. GULISTAN

Numri Identifikues Personal:
Personal Identification Number:
Identifikacioni Lični Broj:

Numri Fiskal:
Fiscal Number:
Fiskalni Broj:

810538473

Komuna:
Municipality:
Opština:

LIPJAN

Data:
Date:
Datum:

13.06.2023

Arsyeja e lëshimit:
Reasoning:
Razlog izdavanja:

Aplikim për Tender

ka këtë gjendje tatimore në ATK:

has the following tax position with the TAK:

ima sledeću poresko stanje u PAK:

Personi është i regjistruar në ATK dhe nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore.

ATK vërteton se informatat e dhëna janë të sakta dhe të plota me datën e këtij vërtetimi tatimor, mirëpo, ky vërtetim nuk përjashton obligimet tatimore që mund të lindin në të ardhmen.

ATK certifies that this information is correct and complete as of the date of this verification, but this verification does not exclude future tax obligations.

PAK overava da su date informacije tačne i potpune sa datumom ove potvrde, ali ova podvrda ne isključuje poreska obaveza koja mogu nastati u budućnosti.

Vërtetimi vlen 90 ditë nga data e lëshimit

The verification is valid for 90 days from the day it is issued

Potvrda vazi 90 dana od dana kada je izdata

Verifikimin e këtij vërtetimi tatimor, mund ta bëni në linkun -

Verification of this tax verification, you can do on the link - Verifikaciju ove poreske potvrde, možete uveravati i linku:

<https://eVertetimi.atk-ks.org/TaxVer/ReadTaxVer>



LISTA E PAGAVE PËR KOMPANINË

ATK-KS\Hlukaj

6/8/2023 8:48:24 AM

NR FISKAL	810538473
EMRI I KOMPANISË	Q.E.A. GULISTAN
ADRESA	BANULLË
LLOJI I BIZNESIT	Ortakëria e përgj.
QENDRA TATIMORE	DTMS
VITI	2023

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo Finansija / Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo

Arkiva / ARHIVA / ARCHIVE

Njësia Origj: _____ Nr. Prot: _____
Org. Jedin: _____ Pr. Prot: _____
Org. Unit: _____ Prot. No: 1831/23

Nr. faqeve: 9 Data: 08.06.23
Broj stranica: _____ Datum: _____
No. pages: _____

Dalëse Q SH T. PRISHTINË

MUAJT

NR	EMRI	MBIEMRI	NR PERSONAL	PRIM	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
1	ABDULLA	DAUTI	1007499945	PO	+	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-
2	ABETARE	SHALA	1240531603	PO	+	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-
3	ADELAIDA	ASLLANI	1500858423	PO	+	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-
4	ADELINA	GASHI	1240576291	PO	+	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-
5	ADELINA	HOXHIAJ	1241456842	PO	+	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-
6	ADELINA	KRASNIQI	1240542206	PO	+	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-
7	ADELINA	SHALA	1176386572	PO	+	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-
8	ADNAN	REÇBER	1231961948	PO	+	+	+	+	-	-	-	-	-	-	-	-
